



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 06.06.2022

MBI

**KËRKESËN PËR LICENCIM TË SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 866/4 prot., datë 02.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 20.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/13 prot., datë 22.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 469/1 prot., datë 27.04.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Duke qenë se dokumentacioni plotësues i depozituar nga shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/3 prot., datë 11.05.2022, nuk plotësonte tërësisht kërkesat e rregullores, ERE iu drejtua shoqërisë sërish me shkresën nr. 469/4 prot., datë 18.05.2022.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 495/6 prot., datë 24.05.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.
- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me qëllim sqarimin/dokumentimin e informacionit plotësues të sjellë nga shoqëria si dhe depozitimin në ERE të vërtetimit të prokurorisë për administratorin e saj, vlerësohet e arsyeshme që shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të paraqesë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentat e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të paraqesë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentat e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI